REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	**03.02.2023**
Referencë	**11-344/1**
Për :	**Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës**
Kopje:	**Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës**
Kopje:	**Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës**
Nga:	**Flamur Sylejmani - Drejtori i Inspekcionit**
Lënda :	**Raporti i muajit-janar**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Inspektorët e trafikut:
Inspektoret e trafikut në muajin janar janë ballafaquar me problemin e taksisteve-fizik pa licencë dhe taksisteve-juridik pa licencë. Ndaj të gjitha rasteve të ndaluara e të identifikuara si të pa rregullta, janë marr të gjitha masat si: vërejtje, përjashtim nga komunikacioni-marrje e tabelave dhe gjoba.
Janë inspektuar auto-taxit e shoqatës "Ulpiana" në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" inspektimi është bërë për Licencë dhe ngjyrë të automjeteve me të cilat realizojnë veprimtarin taksi.
Në rrugën "Iliria" është inspektuar objekti banesorë ku është urdhëruar që gjatë punimeve të bëjë pastrimin e rrugës dhe ta mirëmbajë vazhdimisht rrugën të cilën e shfrytëzon për bartjen e materialit ndërtimor.
Gjithashtu, inspektorët e trafikut kanë inspektuar disa rrugë për ndriçimin publik ku disa biznese kanë vendosur në shtylla të ndriçimit disa kabllo të rrymës dhe internetit të cilët janë urdhëruar të bëjnë largimin e kabllov. Urdhëresa e dhënë nga inspektorët e trafikut është respektuar.

Inspektori i ambientit:
Inspektori i ambientit i është përgjigjur ankesave të qytetarëve nga lokalitete të ndryshme. Njëra nga kërkesat kishte të bënte me problem të kanalizim për shkak të reshurave atmosferike dhe probleme tjera me ujërat atmosferik.
Është inspektuar tek objektet shumë banesor në rrugën: "Skënderbeu", "Ganimete Terbeshi", "Avdi Kelmendi" në lidhje me zbatimin e kushteve të LMK-së. Investitorëve ju është dhënë urdhëresë për rregullimin e vendit për vendosjes e kontejnerëve për mbeturina dhe rregullimin e hapësirës gjelbëruese sipas projektit të lejes ndërtimore.
Janë inspektuar deponit në fshatin Grackë e Vjetër, Topliqan Poturovc (Kodra e Kërçevës), Shalë, Sllovi.

Inspektorët e tregut:
Janë inspektuar subjektet të ndryshme afariste, si marketet, barnatoret, mishtoret, sallonet e ondollimit, lokalet për shitjen dhe servisim të telefonav mobil, industri të drurit. Qëllimi i inspektimit ka qenë rreth regjistrimit të biznesit, pranimeve teknik, çmimeve të deklaruara, përputhshmëria e çmimeve raft-arkë, vendosja e flamujve-tregues të origjinës se produkteve.
Në rastet (në inspektimet) ku nuk ka pasur përputhshmëri të çmimeve raft-arkë është iniciuar procedurë kundërvajtëse.
Është bërë inspektimi i zakonshëm i tregjeve ditëve të hënë edhe në rastet kur kanë qenë ditë pushimi.
Fokus kishim që ti urdhëronim me procesverbal barnatoret humane edhe mishtoret që të deklarojnë çmimin e produkteve në raft edhe vendosjen e flamujve tregues të origjinës.

Inspektorët e ndërtimit:
Përgjatë muajit janar inspektorët e ndërtimtarisë kanë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në teren. Me procesverbal është evidentua dhe konstatuar për të gjitha ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi.
Për secilin rast janë ndjekur hapat procedural ligjore, ndalimi i ndërtimit, vendosja e shiritave. Janë bërë ndalime të punimeve, madje është nxjerr aktvendim për rrenim.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit janar janë:

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.
Urdhëresa me procesverbal për deklarimin e çmimit të produkteve në raft dhe vendosjen e flamujve-tregues të origjinës për barnatoret humane dhe mishtoret.
Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.
Inspektimi i auto-taksive në qytetin e Lipjanit.
Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.
Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.
Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin "Adem Jashari" në Vrell.
Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknik	Fletëparaqitje	Vendosje të shiritave zyrtar	Kallëzim penal	Vërejtje, njoftime	Rënim i objektitit	Të hyra nga pranimet teknike	Punë me palë, kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygjesore	Gjoba mandatore	Barazim i të hyrave	Biznese të paregjistruara	Biznese pa pranime teknike të lokaleve afariste	Konfiskim i targave dhe librezës	Menaxhim I tregjeve dhe i kontratave për ndërtim	Aktvendime, ndalesa, urdhëresa, vendime ,shkresa	Inspektim me polici	Ankesa të konsumatorëve
Biznesi	138	25	10	3					275.00€	40	16			1	2	8		9	21		3
Ambienti	23	7					2			3	7	1								3	
Ndërtimi	17	5			2		2			5									3		
Trafiku	79	8					29			23			1				6	4	4	4	
Gjithsej	257	45	10	3	2		33		275.00€	71	23	1	1	1	2	8	6	13	28	7	3

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur. Takimet i kemi mbajtur me pronar të bizneseve dhe me qytetarë në mënyrë individuale,

TAKIME TË TJERA

Takimet kryesisht i kemi mbajtur me qytetarë, pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore përgjatë zonave urbanistike-ndërtuese dhe parandalimi i tyre duke ndërmarr masa ligjore.
Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.
Inspektimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet si dhe mbrojtja e hapësirave gjelbëruese, ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore.
Inspektime të auto-taksive si dhe i firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi në çdo lëmi që të njoftojnë Drejtoratin e Inspekcionit, në mënyrë që cilësia në shërbime të jetë në nivel më të mirë të mundshëm.